



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr.

Dt. 24.12.2025

409.1-29245/14

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative , Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) nenit 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, , Kryetari i komunës së Dragashit nxjerrë këtë:

U R D H Ë R E S Ë

- I. **NDALOHET** përdorimi i produkteve piroteknike në vendet e hapura publike, përkatësisht në tregje, rrugë, sheshe dhe në oborret e institucioneve publike.
- II. Ndalesa sipas pikës "I" të kësaj urdhërese vlen për periudhën nga data 25 Dhjetor 2025 deri më 10 Janar 2026, me përjashtim të datës 31.12.2025, nga ora 23:00 – 00:30 e datës 01.01.2026 (një orë e tridhjetë minuta).
- III. Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese do të ndëshkohen sipas ligjeve në fuqi.
- IV. Për zbatimin e kësaj urdhërese do të kujdeset Inspektorati i Komunës së bashku me Policinë e Kosovës – SP Dragash
- V. Me këtë urdhëresë njoftohet Stacioni Policor në Dragash
- VI. Urdhëresa hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit.

Urdhëresa u dërgohet:

1. Policia e Kosovës – Stacioni Policor Dragash,
2. Inspektionit të Komunës së Dragashit
3. Arkivit

Kryetari i komunës



Bexhet Xheladini